**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
**VLORE**

**Nr.Rregj.Them. 369** — **Nr. Vendimi 369**
**Data e rregjistrimit 01.09.2010** — **Data 11.10.2010**

# V E N D I M
**" Ne emer te Republikes"**

Gjykata e rrethit gjyqesor Vlore e perbere nga;

Klodiana Gjyzari- Gjyqtare

Asistuar nga sekretarja e seances gjyqesore Rezana Aliu, sot me 11.10.2010, ora 09, ne Vlore ne seance gjyqesore publike, mori ne shqyrtim ceshtjen penale nr 369, qe i perket:

**KERKUES:** [redacted], I biri [redacted], dtl. 1956, lindur ne Roms, Vlore dhe banues ne Vlore, l. "1 Maji", i mbrojtur nga av[redacted], i zgjedhur prej tij.

**ME PJESEMARRJEN E:** Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, e perfaqesuar nga prokuror [redacted]

**OBJEKTI:** Kthimin e sendit te sekuestruar
**Baza ligjore:** neni 208 e vijues dhe 301/2 i K.Pr.Penale.

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses, pasi degjoi:
-Mbrojtesin e kerkuesit i cili perfundimisht kerkoi kthimin e sendit, automjetit i tipit benc mercedes me targe VL[redacted], me nr. Shasije WDB[redacted] si dhe te dokumentacionit shqiptar te ketij automjeti.
-Prokurorin i cili u shpreh qe kthimi i sendit nuk pengon dhe nuk demton ceshtjen
-si dhe shqyrtoi aktet ne teresi:

# V E R E N

Se, kerkuesi [redacted] ka paraqitur prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore nje kerkese me te cilen kerkon t'i kthehet sendit, automjetit i tipit benc mercedes me targe VL [redacted], me nr. Shasije [redacted] si dhe te dokumentacionit shqiptar te ketij automjeti duke qene se nuk demtohen hetimet dhe gjykimi i ceshtjes.

Sipas prokurorise eshte e vertete qe per interes te nje procedimi penal per nje ngjarje te ndodhur ne date 22.08.2010 ne l. "10 Korriku" Vlore, ku eshte tentuar te vritet shtetasi Fitim Imeri, eshte sekuestruar nga ana e policise gjyqesore automjeti i tipit benc mercedes me targe VL [redacted], me nr. Shasije [redacted] si dhe te dokumentacionit shqiptar te ketij automjeti kerkuesit [redacted]. Verifikimet lidhur me kete mjet jane kryer dhe veprimet procedurale me te kane mbaruar.

Prokuroria spjegoi se kthimi i automjetit kerkuesit [redacted] nuk demton hetimin e procedimit penal perkates dhe gjykimin e ceshtjes penale ne te ardhmen.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor gjykata cmon se u provua qe:

-Nga procesverbali per sekuestrimin e automjetit prove materiale dt. 23.10.2010 rezulton se nga oficeri i policise gjyqesore eshte sekuestruar automjeti i tipit benc mercedes me targe [redacted], me nr. Shasije [redacted] si dhe te dokumentacionit shqiptar te ketij automjeti kerkuesit [redacted]

Nga ana e prokurorise u deklarua se nuk eshte e nevojshme mbajtja e sekuestros mbi kete send dhe eshte e mundur kthimi i tij kerkuesit.

Ne nenin 217/1 te K.Pr.penale parashikohet se:

*"Kur nuk eshte e nevojshme mbajtja e sekuestros per qellime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij i takojne edhe para se te merret vendimi perfundimtar. Kur eshte e nevojshme, organi procedues urdheron te sillen sendet e kthyera."*

Gjykata bazuar ne nenin 217/1 te K.Pr.Penale cmon se sendi, automjetit tip automjeti i tipit benc mercedes me targe [redacted], me nr. Shasije [redacted] si dhe te dokumentacionit shqiptar te ketij automjeti, leje qarkullimi me nr . 0007925 me nr. Serije 0101313 te ketij automjeti nuk i nevojiten me hetimit te ceshtjes, ne keto kushte gjykata cmon se kerkesa e kerkuesit [redacted] per kthimin e tyre eshte e bazuar ne ligj.

**PER KETO ARSYE**

Gjykata, bazuar ne nenin 217/1 te K.Pr.Penale

**VENDOSI**

1. Pranimin e kerkeses se kerkuesit [redacted]
2. Kthimin e sendit, automjetit i tipit benc mercedes me targe [redacted], me nr. Shasije WDB [redacted] si dhe te dokumentacionit leje qarkullimi me nr [redacted] me nr. Serije 0101313 te ketij automjeti kerkuesit [redacted]
3. Urdherohet Policia Gjyqesore per zbatimin e ketij vendimi.
4. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te kerkuesit.

5. Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Vlore brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes.

Vlore, me 11.10.2010

Sekretare
Rezana Aliu

Gjyqtare
Klodiana Gjyzari

VENDIMI MORI FORME
TE PRERE
NE DATE: 21 / 10 /2010
*KANCELARE*
IRMA DHIMITRIADHI